



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

UDHËZUES

Për zëvendës-kryesuesin e Kuvendit të Komunës për komunitete

Prishtinë, 2015

Hyrje

Udhëzuesi për Zëvendës-kryesuesin e Kuvendit të Komunës për komunitete është hartuar konform mandatit ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për të ofruar komunave këshilla dhe shpjegime të cilat kanë për qëllim të përkrahin autoritetet komunale në zbatimin më të mirë të obligimeve ligjore, që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës. Ky udhëzues nuk ka karakter të aktit ligjor, mirëpo do t'i shërbej Zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete në zbatimin më të lehtë të detyrave të punës.

Përmes këtij udhëzuesi synojmë të sqarojmë rolin e Zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete si mekanizëm lokal i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve me rastin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave lokale, që ndikojnë në afirmimin e të drejtave të komuniteteve që jetojnë brenda komunës, forcimin e instrumenteve të adresimit të çështjeve dhe politikave në të mirë të komuniteteve, sigurimin e kushteve për kryerjen e përgjegjësive ligjore në mënyrë efektive, si dhe bërjen më aktiv të kuadrit politik të komuniteteve në nivel lokal për zgjidhjen e problemeve dhe nevojave të komuniteteve joshumicë.

Qëllimi i Udhëzuesit

Udhëzuesi sqaron rëndësinë e pozitës së Zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale, rolin dhe përgjegjësitë, procedurën e emërimit, shkarkimit, detyrat gjatë ushtrimit të funksionit, bashkëpunimin me mekanizmat lokal dhe qendror për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, raportimin, kodin e mirësjelljes dhe konfliktin e interesit.

Qëllimi i udhëzuesit është që të shërbejnë si mjet praktik për Zëvendëskryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete dhe mekanizmat tjerë lokal për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, duke i udhëzuar për mënyrën e ndërmarrjes së veprimeve si dhe krijimin e një ambienti të sigurt përmes njohjes, shqyrtimit dhe adresimit të të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

Udhëzuesi synon të vë në pah ekzistimin e politikave efektive dhe mekanizmave të përshtatshëm në nivelin lokal, të cilët mund të ndikojnë që të drejtat dhe interesat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë të adresohen më lehtë.

1. Përkufizimi i komunitetit dhe Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete

1.1 "Komunitet" do të thotë grup komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor.¹ Për qëllim të këtij dokumenti, shprehja komunitet/komunitetet i referohet të gjitha komuniteteve të cilat përbëjnë pakicën numërore në nivel komunal në Kosovë.

1.2 Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është pozitë e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës², Ligjit për Vetëqeverisje Lokale³ dhe Statutin e Komunës në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve joshumicë dhe ka për qëllim të promovoj dialogun ndërmjet komuniteteve dhe shërbejë si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të gjitha komuniteteve joshumicë në mbledhjet e kuvendit të komunës.

2. Mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete

2.1. Mandati i Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Sipas legjislacionit në fuqi, Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete ka përgjegjësitë sinë vijim:

2.1.1 Promovon dialogun ndërmjet komuniteteve, nxitë ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe kuvendit të komunës dhe promovon konsultimin dhe përfshirjen e komuniteteve në punën e Kuvendit të komunës, si më poshtë:

- Në konsultim me Kryesuesin e Kuvendit të komunës, Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është përgjegjës për promovimin dhe lehtësimin e dialogut ndërmjet komuniteteve dhe forcimin e marrëdhënieve të mira dhe të komunikimit ndërmjet komuniteteve.

¹ Përkufizimi për komunitete ne Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale në Kosovë i datës 20 shkurt 2008, neni 3

² Neni 62 i Kushtetutës të Republikës të Kosovës

³Nenet54 dhe 55

- Në bashkëpunim me Nënkryetarin e komunës për komunitete, Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete lehtëson përfshirjen e komuniteteve në punën e Kuvendit të komunës, si në takimet publike për buxhetin, rregulloret dhe planet komunale etj., si dhe lehtëson dhe mbështetë komunikimin dhe aktivitetet në terren.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete promovon ngritjen e besimit brenda strukturave komunale dhe në mesin e komuniteteve, duke ndërmarrë aktivitete në praktikë që prekin komunitetet, lehtësimin e komunikimit ndërmjet komuniteteve dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe mbajtjen e një politike të detyrë të hapura për vizita përmes orarit të punës të reklamuar mirë.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete vepron si një pikë kontaktuese për trajtimin e brengave të komuniteteve dhe interesave në mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe lehtëson koordinimin e strukturave relevante komunale si dhe të komuniteteve për zgjidhjen e problemeve, ofron përgjigje konstruktive krahas çështjeve, iniciativa afatgjate për të promovuar marrëdhëniet e mira ndërmjet komuniteteve në komunë. Palët relevante të interesuara komunale që angazhohen në aktivitete të tilla, përfshijnë mekanizmat e nivelit lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave për komunitete.

2.1.2. Është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet dhe vendimet e Kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese.

- Shqyrton ankesat që parashtrihen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre për të parë nëse aktet dhe vendimet e Kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.
- Sipas ankesave të pranuar, i referon Kuvendit të komunës rishqyrtimin e akteve/vendimeve të miratuara të cilat pretendohet se janë në kundërshtim me të drejtat e garantuara kushtetuese për komunitetet.
- Parashtron çështjet në Gjykatën Kushtetuese në rastet kur Kuvendi i komunës nuk ka rishqyrtuar aktin/vendimin e kontestuar, si dhe në rastet kur Kuvendi ka rishqyrtuar aktet/vendimet, dhe edhe pas rishqyrtimit, pretendohet se ai

akt/vendim ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara të komuniteteve me Kushtetutë.

2.1.3. Shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të të gjitha komuniteteve që nuk janë shumicë në mbledhjet e Kuvendit të komunës

- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të komunës, konsultohet për pikat e rendit të ditës që kanë të bëjnë me çështje të komuniteteve dhe propozon politika në favor të komuniteteve⁴.
- Në konsultim me qytetarët dhe shoqërinë civile identifikon nevojat e komuniteteve.
- Takohet me qytetarë në baza të rregullta dhe promovon një politikë të “dyerve të hapura”.

2.1.4. Bashkëpunon me mekanizmat lokal për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve

- Merr pjesë në takimet e komitetit për komunitete dhe bashkëpunon për shqyrtimin e politikave komunale që prekin interesat e komuniteteve dhe për t’u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete kujdeset që rekomandimet e komitetit për komunitete të diskutohen në mbledhjet e Kuvendit të komunës.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete përmes Nënkryetarit të komunës për komunitete mund t’i rekomandojë Kryetarit të komunës ndërmarrjen e veprimeve të caktuara lidhur me të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve që pretendohet se u janë shkelur ato të drejta.

⁴ Sqarim: Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me anëtarët e tjerë të Kuvendit të komunës që vijnë nga radhët e komuniteteve.

- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete bashkëpunon me Zyrën komunale për komunitete dhe kthim dhe mund të ketë qasje në raportet e rregullta të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim të cilat i dorëzohen Kuvendit të komunës.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete përmes kryesuesit të komitetit për komunitete mund të adresojë në Këshillin komunal për siguri në bashkësi shqetësimet dhe nevojat që paraqiten në lidhje me sigurinë në bashkësi.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete siguron bashkëpunim të rregullt ndërmjet mekanizmave lokal për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete po ashtu siguron bashkëpunim të rregullt ndërmjet organeve të tjera të komunës.

3. Procedura për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete

- Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo-shumicë, posti i Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete nuk mund të emërohet në ato komuna ku nuk përmbushet kriteri prej 10% të qytetarëve që i takojnë komuniteteve joshumicë.
- Postin e Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo-shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e komunës.
- Duke marrë parasysh raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me rezultatet e zgjedhjeve për subjektet politike dhe kandidatët veç e veç brenda subjekteve, kryesuesi i kuvendit të komunës, konfirmon kandidatin për Zëvendëskryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet e drejtpërdrejta për

Kuvendin e komunës, nga radhët e komuniteteve pakicë që jetojnë në komunën përkatëse.

- Në rast të lirit të pozitës së Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete për çfarëdo arsye, vendin e Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e plotëson kandidati nga radhët e komuniteteve jo-shumicë i cili ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet e drejtpërdrejta për Kuvendin e komunës.
- Mandati i Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
- Mandati i Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete pushon me rastin e:
 - Përfundimit të mandatit të tij/saj;
 - Nëse ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
 - Nëse paraqet dorëheqjen më shkrim nga posti i tij/saj në Kuvendin e komunës;
 - Nëse sipas aktgjykimit të gjykatës së formës së prerë dënohet për veprë penale për të cilën parashihet dënimi më burgim për 6 muaj ose më tepër;
 - Nëse mungon pa arsye për 3 muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të komunës.

4. Raportimi i Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete dhe mbikëqyrja e punës së tij/saj

- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete raporton për punën e tij/saj para anëtarëve të Kuvendit të komunës.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete poashtu, në frymën e bashkëpunimit, informon Komitetin për komunitete, Nënkryetarin e komunës për komunitete, Zyrën komunale për komunitete dhe kthim lidhur më punën e tij/saj.

Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete informon autoritetin mbikëqyrës Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me punën e tij/saj sipas kërkesës për raportim. Raportimi bëhet me shkrim dhe gojarisht.

5. Kodi i mirësjelljes dhe konflikti i interesave

- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij/saj, ka interes personal apo financiar.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete ruan integritetin dhe pavarësinë e tij/saj gjatë gjithë kohës.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete shqyrton çështjet pa vonesë dhe me efikasitet.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete duhet t'i paraqesë të gjitha konfliktet e interesit që lindin, në secilën prej mbledhjeve ku ai/ajo merr pjesë.
- Statuti i komunës dhe Rregullorja e punës parashohin masat që duhet të merren për të përjashtuar Zëvendëskryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ai/ajo ka konflikt të interesit.
- Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, në cilësinë e tij/saj zyrtare, nuk pranon dhurata, të holla apo përfitime të tjera nga cilido person.
- Pa paragjykuar dispozitat mbi konfidencialitetin, Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete ofron informata të sakta për të gjitha çështjet dhe rreth statusit të vet.